



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.796/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22.10.2021 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Sark” SHPK, në procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozime”, Nr. REF-85860-02-03-2021 me objekt “Blerje çakëlli”, me fond limit 5,832,684 (pesë milion e tetëqind e tridhjetë e dy mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 15.02.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kavajë.

Ankimues: “Sark” SHPK
Adresa: Lagjja 8 Shkurti, Rruga Skëndërbej, Rajoni nr. 3, Përball supermarket Lalaj, Fier

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Kavajë
Adresa: Bulevardi “Josif Budo”

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e

Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”,

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.3. Nuk ka respektuar shkallët e ankimimit dhe afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 05.02.2021 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Kërkesë për Propozime*”, Nr. REF-85860-02-03-2021 me objekt “*Blerje çakëlli*”, me fond limit 5,832,684 (pesë milion e tetëqind e tridhjetë e dy mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 15.02.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kavajë.

II.2. Në datën 15.02.2021 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 29.08.2021 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Murati	4,954,950.00	I skualifikuar
- Kegli-Duri	5,426,850.00	I skualifikuar
- Sark	5,281,920.00	I skualifikuar
- Sinameta	5,423,400.00	I skualifikuar

II.4. Në datën 29.08.2021 operatori ekonomik “Sark” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

II.5. Në datën 02.09.2021 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e mësipërme të prokurimit në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë:

- Në vlerësimin përfundimtar të procedurës publike KVO e Bashkisë Kavajë, ka vendosur të refuzojë ofertën e firmës Sark SHPK me pa të drejtë me arsye se:
Në pikën 1/dh. të kriterëve të veçanta të kualifikimit është kërkuar një Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. - Vërtetimi i paraqitur mbi shlyerjen e detyrimeve ndaj OSHEE është lëshuar në emër të z. Arben Kajolli dhe jo në emër të shoqërisë pjesëmarrëse në procedurën e prokurimit dhe si pasojë nuk mund të vërtetohet ka apo jo detyrime shoqëria pjesëmarrëse. Ju sqarojmë se: vërtetimi i lëshuar nga OSHEE ku mban firmën dhe vulën e institucionit përkatës citon se: kërkuesi Sark SHPK ku titullar i së cilës është z. Arben Kajolli me nr. Kontrate F11A020245307491, ka detyrime 0, përfshirë edhe faturën koherente të muajit dhjetor 2020. Pra, kjo nuk përbën arsye skualifikimi.
- Në pikën 1/d “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit” është kërkuar që ofertuesi duhet të deklarojë se: d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi. Nga vërtetimi i lëshuar me datë 14.12.2020 me nr. Prot 339 nga Drejtoria e shërbimit të tatimpaguesit rezulton me detyrime për tatimin mbi vlerën e shtuar në masën 527,114 lekë. Nga ana jonë është paraqitur vërtetimi Nr. 339 datë 14.12.2020 nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, ku në bazë të aktmarrëveshjes Nr. 10973/2 datë 19.10.2020, për pagesën me këste të detyrimeve tatimore, gjë që e justifikon detyrimin tatimor. Pra pagesa bëhet çdo muaj me këste.
- Në pikën 2.2.3 të Kriterëve të veçanta të kualifikimit është kërkuar Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2020, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të Ligjit nr.

Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit. Në lidhje me taksat vendore rezulton se është ushtruar aktivitet edhe në Bashkitë Tiranë, Delvinë dhe Roskovec për të cilat janë paraqitur vetëm fatura dhe jo vërtetim për shlyerjen e detyrimeve duke mos vërtetuar se janë shlyer plotësisht detyrimet. Arsyetimi juaj nuk qëndron, sepse ne kemi hedhur në sistemin elektronik vërtetimin e lëshuar nga Bashkia Roskovec dhe Bashkia Delvinë, të cilat mbajnë firmën dhe vulën e autoritetit kontraktor, po kështu edhe për bashkinë Tiranë janë paraqitur mandat pagesat e bankës ku është bërë likuidimi i shumës, gjë që e cila vërteton që ne kemi bërë pagesat në bazë të ligjit. Kjo nuk përbën arsye për skualifikim. Në procedurën e zhvilluar nga autoriteti juaj KVO Bashkia Kavajë, mendojmë se, nuk ka bërë vlerësimin e duhur ndaj kompanisë Sark SHPK pasi ne kemi paraqitur në sistem të gjithë dokumentacionin e kërkuar në DST nga ana juaj, për këtë prokurim publik dhe ju kemi detyrimin ligjor të bëni vlerësimin për të gjithë dokumentacionin e kërkuar, si autoritet kontraktor dhe të hedhur nga ana jonë në sistemin elektronik. Drejtoria juridike e Sark SHPK menjëherë vlerëson këtë situatë të krijuar nga KVO për dokumentacionin e kërkuar në DST për këtë procedurë dhe dokumentacionin e hedhur në sistem prej operatorit ekonomik Sark SHPK vëren se: Gjithë dokumentacioni është në rregull dhe se kanë automatikisht vlerë ligjore dhe juridike, për këtë arsye ky skualifikim i bërë prej KVO nuk ka bazë ligjore edhe si i tillë nuk qëndron. E ndodhur përball kësaj shtate të krijuar prej KVO të Bashkisë Kavajë, Drejtoria juridike Sark SHPK menjëherë vlerëson dokumentacionin e kërkuar në DST për këtë procedurë dhe dokumentacionin e hedhur në sistem është lehtësisht i qartë dhe i saktë prej operatorit ekonomik Sark SHPK vëren se: Gjithë dokumentacioni është në rregull, për këtë arsye ky skualifikim i bërë prej KVO nuk ka asnjë bazë ligjore edhe si i tillë nuk qëndron. Sark SHPK ka paraqitur ofertën ekonomike më të mirë dhe më të ulët se operatorët e tjerë edhe për këto arsye, plotëson të gjitha kriteret, Sark SHPK është me të drejtë fituesi i këtij prokurimi publik të organizuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Kavajë”.

II.6. Nëpërmjet shkresës nr. 2653/1 prot., datë 13.09.2021, protokolluar me tonën me nr. 1646/2 prot., datë 15.09.2021 me objekt “Shkresë përcjellëse”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit. Në këtë shkresë autoriteti kontraktor ka cituar ndër të tjera se: “Nisur nga sa më sipër operatori ekonomik “Sark” SHPK duhet të ankohet më parë pranë Autoritetit Kontraktor dhe pas një vendimi ose kalimit të afatit për përgjigje mund t’i drejtohet KPP”.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr. 1646/3 prot., datë 28.09.2021, Komisioni i Prokurimit Publik, i dërgoi shkresën me lëndë “Kërkesë për paraqitje provash” drejtuar operatorit ekonomik ankimues “Sark” SHPK, në cilësinë e provës për të vërtetuar dërgimin e formularit të ankesës në fillim pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Me shkresën nr. 1646/4 prot., datë 30.09.2021, operatori ekonomik ankimues “Sark” SHPK, ka dërguar dokumentacion e kërkuar si dhe dëftesën e pranimit të objekteve postare

konkretisht me bar-kodin RR635137028AA, për dorëzimin e formularit të ankesës nëpërmjet shërbimit postar.

II.9. Me shkresat nr. 1646/5 prot., datë 04.10.2021 dhe nr. 1646/6 prot., datë 13.10.2021 me lëndë “*Kërkesë për informacion*” drejtuar shërbimit postar shqiptar Posta Shqiptare SH.A. për të dhënë informacion lidhur me dërgesën postare me kod-bar RR635137028AA, kush e ka marrë në dorëzim, ku është dorëzuar dhe në cilën datë është dorëzuar dërgesa.

II.10. Nëpërmjet shkresës nr. 2037/1 prot., datë 19.10.2021, protokolluar me tonën me nr. 1646/7 prot., datë 20.10.2021 me objekt “*Kthim përgjigje*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i Postës Shqiptare SH.A. lidhur me informacion lidhur me dërgesën postare me kod-bar RR635137028AA. Në këtë shkresë Posta Shqiptare SH.A. ka cituar ndër të tjera se: “*Shoqëria “Sark” SHPK ka depozituar më datë 01.09.2021, pranë zyrës postare Tirana 8/1, objektin postar me barkod RR635137028AA, adresuar Bashkisë Kavajë. Objekti postar pasi është procesuar në sektorët përkatës, është marrë në dorëzim nga punonjësja e Bashkisë Kavajë, Znj. Jona Keçi. Bashkëlidhur ju dërgojmë fotokopje të regjistrit të dorëzimit të objekteve të porositura me nënshkrimin e marrësit*”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës dhe informacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Sark” SHPK për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në datën 05.02.2021 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Kërkesë për Propozime*”, Nr. REF-85860-02-03-2021 me objekt “*Blerje çakëlli*”, me fond limit 5,832,684 (pesë milion e tetëqind e tridhjetë e dy mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 15.02.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kavajë.

III.1.2. Në datën 15.02.2021 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

III.1.3. Në datën 29.08.2021 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Murati	4954950.00	I skualifikuar
- Kegli-Duri	5426850.00	I skualifikuar

- | | | |
|------------|------------|----------------|
| - Sark | 5281920.00 | I skualifikuar |
| - Sinameta | 5423400.00 | I skualifikuar |

III.1.4. Në datën 29.08.2021 operatori ekonomik “Sark” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

III.1.5. Në datën 02.09.2021 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e mësipërme të prokurimit në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë:

- Në vlerësimin përfundimtar të procedurës publike KVO e Bashkisë Kavajë, ka vendosur të refuzojë ofertën e firmës Sark SHPK me pa të drejtë me arsye se:
- Në pikën 1/dh. të kriterëve të veçanta të kualifikimit është kërkuar një Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. - Vërtetimi i paraqitur mbi shlyerjen e detyrimeve ndaj OSHEE është lëshuar në emër të z. Arben Kajolli dhe jo në emër të shoqërisë pjesëmarrëse në procedurën e prokurimit dhe si pasojë nuk mund të vërtetohet ka apo jo detyrime shoqëria pjesëmarrëse. Ju sqarohet se: vërtetimi i lëshuar nga OSHEE ku mban firmën dhe vulën e institucionit përkatës citon se: kërkuesi Sark SHPK ku titullar i së cilës është z. Arben Kajolli me nr. Kontrate F11A020245307491, ka detyrime 0, përfshirë edhe faturën koherente të muajit dhjetor 2020. Pra, kjo nuk përbën arsye skualifikimi.
- Në pikën 1/d “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit” është kërkuar që ofertuesi duhet të deklarojë se: d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi. Nga vërtetimi i lëshuar me datë 14.12.2020 me nr. Prot 339 nga Drejtoria e shërbimit të tatimpaguesit rezulton me detyrime për tatimin mbi vlerën e shtuar në masën 527,114 lekë. Nga ana jonë është paraqitur vërtetimi Nr. 339 datë 14.12.2020 nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, ku në bazë të aktmarrëveshjes Nr. 10973/2 datë 19.10.2020, për pagesën me këste të detyrimeve tatimore, gjë që e justifikon detyrimin tatimor. Pra pagesa bëhet çdo muaj me këste.
- Në pikën 2.2.3 të Kriterëve të veçanta të kualifikimit është kërkuar Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2020, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit. Në lidhje me taksat vendore rezulton se është ushtruar aktivitet edhe në Bashkitë Tiranë, Delvinë dhe Roskovec për të cilat janë paraqitur vetëm fatura dhe jo vërtetim për shlyerjen e detyrimeve duke mos vërtetuar se janë shlyer plotësisht detyrimet. Arsyetimi juaj nuk qëndron, sepse ne kemi hedhur në sistemin elektronik vërtetimin e lëshuar nga Bashkia Roskovec dhe Bashkia Delvinë, të cilat mbajnë firmën dhe vulën e autoritetit kontraktor, po kështu edhe për bashkinë Tiranë janë paraqitur

mandat pagesat e bankës ku është bërë likuidimi i shumës, gjë që e cila vërteton që ne kemi bërë pagesat në bazë të ligjit. Kjo nuk përbën arsye për skualifikim. Në procedurën e zhvilluar nga autoriteti juaj KVO Bashkia Kavajë, mendojmë se, nuk ka bërë vlerësimin e duhur ndaj kompanisë Sark SHPK pasi ne kemi paraqitur në sistem të gjithë dokumentacionin e kërkuar në DST nga ana juaj, për këtë prokurim publik dhe ju keni detyrimin ligjor të bëni vlerësimin për të gjithë dokumentacionin e kërkuar, si autoritet kontraktor dhe të hedhur nga ana jonë në sistemin elektronik. Drejtoria juridike e Sark SHPK menjëherë vlerëson këtë situatë të krijuar nga KVO për dokumentacionin e kërkuar në DST për këtë procedurë dhe dokumentacionin e hedhur në sistem prej operatorit ekonomik Sark SHPK vëren se: Gjithë dokumentacioni është në rregull dhe se kanë automatikisht vlerë ligjore dhe juridike, për këtë arsye ky skualifikim i bërë prej KVO nuk ka bazë ligjore edhe si i tillë nuk qëndron. E ndodhur përball kësaj situatë të krijuar prej KVO të Bashkisë Kavajë, Drejtoria juridike Sark SHPK menjëherë vlerëson dokumentacionin e kërkuar në DST për këtë procedurë dhe dokumentacionin e hedhur në sistem është lehtësisht i qartë dhe i saktë prej operatorit ekonomik Sark SHPK vëren se: Gjithë dokumentacioni është në rregull, për këtë arsye ky skualifikim i bërë prej KVO nuk ka asnjë bazë ligjore edhe si i tillë nuk qëndron. Sark SHPK ka paraqitur ofertën ekonomike më të mirë dhe më të ulët se operatorët e tjerë edhe për këto arsye, plotëson të gjitha kriteret, Sark SHPK është me të drejtë fituesi i këtij prokurimi publik të organizuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Kavajë”.

III.1.6. Nëpërmjet shkresës nr. 2653/1 prot., datë 13.09.2021, protokolluar me tonën me nr. 1646/2 prot., datë 15.09.2021 me objekt “Shkresë përcjellëse”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit. Në këtë shkresë autoriteti kontraktor ka cituar ndër të tjera se: “Nisur nga sa më sipër operatori ekonomik “Sark” SHPK duhet të ankohet më parë pranë Autoritetit Kontraktor dhe pas një vendimi ose kalimit të afatit për përgjigje mund t’i drejtohet KPP”.

III.1.7. Nëpërmjet shkresës nr. 1646/3 prot., datë 28.09.2021, Komisioni i Prokurimit Publik, i dërgoi shkresën me lëndë “Kërkesë për paraqitje provash” drejtuar operatorit ekonomik ankimues “Sark” SHPK, në cilësinë e provës për të vërtetuar dërgimin e formularit të ankesës në fillim pranë autoritetit kontraktor.

III.1.8. Me shkresën nr. 1646/4 prot., datë 30.09.2021, operatori ekonomik ankimues “Sark” SHPK, ka dërguar dokumentacion e kërkuar si dhe dëftesën e pranimit të objekteve postare konkretisht me bar-kodin RR635137028AA, për dorëzimin e formularit të ankesës nëpërmjet shërbimit postar.

III.1.9. Me shkresat nr. 1646/5 prot., datë 04.10.2021 dhe nr. 1646/6 prot., datë 13.10.2021 me lëndë “Kërkesë për informacion” drejtuar shërbimit postar shqiptar Posta Shqiptare SH.A. për të dhënë informacion lidhur me dërgesën postare me kod-bar RR635137028AA, kush e ka marrë në dorëzim, ku është dorëzuar dhe në cilën datë është dorëzuar dërgesa.

III.1.10. Nëpërmjet shkresës nr. 2037/1 prot., datë 19.10.2021, protokolluar me tonën me nr. 1646/7 prot., datë 20.10.2021 me objekt “*Kthim përgjigje*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i Postës Shqiptare SH.A. lidhur me informacion lidhur me dërgesën postare me kod-bar RR635137028AA. Në këtë shkresë Posta Shqiptare SH.A. ka cituar ndër të tjera se: “*Shoqëria “Sark” SHPK ka depozituar më datë 01.09.2021, pranë zyrës postare Tirana 8/1, objektin postar me barkod RR635137028AA, adresuar Bashkisë Kavajë. Objekti postar pasi është procesuar në sektorët përkatës, është marrë në dorëzim nga punonjësja e Bashkisë Kavajë, Znj. Jona Keçi. Bashkëlidhur ju dërgojmë fotokopje të regjistrit të dorëzimit të objekteve të porositura me nënshkrimin e marrësit*”.

III.1.11. Në rastin konkret, referuar formularit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Sark” SHPK, më datë 02.09.2021 pranë KPP, Komisioni konstaton se ka dorëzuar formular ankese drejtuar njëkohësisht autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Referuar parashtrimeve në ankesë rezulton se, ankimuesi nuk ka referuar asnjë bazë ligjore. Lidhur me këtë fakt, Komisioni sqaron ankimuesin se, kjo procedurë është publikuar Njoftimi i Kontratës në datën 05.02.2021 dhe zhvilluar në datën 15.02.2021, për të cilën është përdorur dokumentet standarde të tenderit referuar ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe në faqen e tij zyrtare, Komisioni ka publikuar njoftimin nr. 524 Prot., datë 02.04.2021 drejtuar autoriteteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë duke sqaruar ndër të tjera si vijon: “*...Për procedurat e nisura të prokurimit, për të cilat Urdhri i Prokurimit ka dalë para datës 31 Mars 2021, procesi i ankimimit administrativ do të ndiqet në përputhje me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” (i ndryshuar)*”. Gjithashtu, Agjencia e Prokurimit Publik në njoftimet e publikuara në faqen zyrtare të saj, drejtuar autoriteteve kontraktore si dhe operatorëve ekonomikë, me njoftimin nr. 2109/1 Prot., datë 30.03.2021 ka sqaruar ndër të tjera: “*...për procedurat e prokurimit që do të hidhen në SPE nga Autoritetet Kontraktore, ditën e sotme, datë 30.03.2021, do të zbatohet ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar*”. Me njoftimin nr. 2109/2 Prot., datë 31.03.2021 ka sqaruar si vijon: “*Në zbatim të parashikimeve të nenit 134, pika 1, të Ligjit 162/2020, procedurat e nisura përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, vijnë të realizohen në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Pra, në zbatim të kësaj dispozite ligjore sqarohet se, për procedurat e prokurimit për të cilat Urdhri i Prokurimit ka dalë përpara datës 31.03.2021. do të vijohet me zbatim të ligjit nr. 9643/2006”.* Në datën 29.08.2021 operatori ekonomik “Sark” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi. Sipas informacion të dërguar nga autoriteti kontraktor Bashkia Kavajë, me shkresën kthim përgjigje me nr. 2653/1 prot., datë 13.09.2021, protokolluar me tonën me nr. 1646/2 prot., datë 15.09.2021, sipas së cilës ka informuar se *operatori ekonomik “Sark” SHPK duhet të ankohet më parë pranë Autoritetit Kontraktor dhe pas një vendimi ose kalimit të afatit për përgjigje mund t’i drejtohet KPP*. Komisioni gjykon se në rastin konkret ndodhemi në kuptimin klasik të barrës së provës referuar parimit juridik *onus probandi incumbit actor* (barra e provës i bie kërkuesit) si edhe në përputhje me nenin 82 pika 1 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në të cilin parashikohet se: “*në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inician procedurën, barra e provës për faktet*

e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj.” Operatori ekonomik ankimues në asnjë rast nuk ka sqaruar, argumentuar dhe më pas provuar me dokumente shtesë faktin se ankimi i paraqitur nga ky i fundit është dorëzuar në fillim pranë autoritetit kontraktor duke pritur të gjitha afatet ligjore që parashikon ligji i prokurimit publik në fuqi në kohën e zhvillimit të procedurës. Për këtë arsye, KPP i është drejtuar me shkresën nr. 1646/3 prot., datë 28.09.2021 me lëndë “Kërkesë për paraqitje provash” drejtuar operatorit ekonomik ankimues “Sark” SHPK, në cilësinë e provës për të vërtetuar dërgimin e formularit të ankesës në fillim pranë autoritetit kontraktor. Ankimuesi dërgoi pranë KPP dokumentin si provë “dëftesën e pranimit të objekteve postare me barkodin RR635137028AA”, për dorëzimin e formularit të ankesës nëpërmjet shërbimit postar. Për të gjykuar në mënyrë të drejtë dhe transparente, Komisioni iu drejtuar Postës Shqiptare SH.A duke i kërkuar informacion në lidhje me dorëzimin e dërgesës me barkodin RR635137028AA, e cila në kthim përgjigje referoi se objektin postar me barkod RR635137028AA, adresuar Bashkisë Kavajë. Objekti postar pasi është procesuar në sektorët përkatës, është marrë në dorëzim nga punonjësja e Bashkisë Kavajë, Znj. Jona Keçi. Bashkëlidhur ju dërgojmë fotokopje të regjistrit të dorëzimit të objekteve të porositura me nënshkrimin e marrësit. KPP konstatoi se, fotokopje të regjistrit të dorëzimit të objekteve të porositura bashkëlidhur kthim përgjigjes nga Posta Shqiptare SH.A. mban datën 03.09.2021. Pra, autoriteti kontraktor ka marrë dijeni për formularin e ankesës së ankimuesit më datë 03.09.2021, ndërkohë në shkresën kthim përgjigje ka dhënë informacion që nuk ka marrë ankesë nga operatorit ekonomik ankimues “Sark” SHPK. Për sa u parashtrua më lart si dhe referuar njoftimeve të publikuara në faqet zyrtare të KPP dhe APP, Komisioni gjykon se ankesa e operatorit ekonomik ankimues, depozituar me datë 03.09.2021 në autoritet kontraktor si edhe me datë 02.09.2021 në Komisionin e Prokurimit Publik, nuk ka zbatuar afatet e ankimit të përcaktuar në ligjin e posaçëm nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili ka qenë në fuqi në kohën e zhvillimit të procedurës objekt ankimi. Konkretisht, në datën 29.08.2021 operatori ekonomik “Sark” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi. Komisioni sqaron se, ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas ligjit nr. 9643/2006. Rrjedhimisht, KPP gjykon se, rregullimi ligjor sa i takon afateve të ankimit administrativ të parashikuar në fushën e prokurimeve në fuqi, i cili në rastin konkret duhet të ishte zbatuar drejtpërdrejtë nga operatori ekonomik ankimues “Sark” SHPK, në kohën e zhvillimit të procedurës.

III.1.12. Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik “Sark” SHPK lidhur me skualifikimin e ofertës së tij referuar informacionit të autoritetit kontraktor dhe Postës Shqiptare SH.A., depozituar pranë KPP-së, nuk janë ngritur fillimisht pranë autoritetit kontraktor, por vetëm pranë KPP-së duke mos respektuar kështu shkallët e ankimit të përcaktuara në nenin 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku përcaktohet qartësisht se: “1. Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet

nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.

1.1 Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni.

2. Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.

3. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi përpara skadimit të afatit kohor, të përcaktuara në pikat 5 dhe 6 të këtij neni.

4. Nëse është e nevojshme, autoriteti kontraktor zgjat afatet kohore të procedurës së prokurimit për periudhën e pezullimit, të përmendur në pikën 3 të këtij neni. Në rast se afatet kohore të procedurës së prokurimit, të njoftuara për ofertuesit, ndryshojnë për shkak të shqyrtimit të ankesës, autoriteti kontraktor duhet të njoftojë të gjithë ofertuesit për arsyet e zgjatjes së afatit kohor. Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t'ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës.

6. Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor.

*7. Ankesa në Komisionin e Prokurimit Publik bëhet me formularin përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete, baza ligjore dhe përshkrimi i shkeljes, pretendimi i ankuesit për vendimin përfundimtar, **shkallët e ankimit, shoqëruar me dokumentacionin përkatës dhe vendimin e autoritetit kontraktor**". Elementet e mësipërme janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Komisioni i Prokurimit Publik e shqyrton ankesën në përputhje me këtë ligj, Kodin e Procedurave Administrative dhe rregullat e prokurimit publik. **Mosndjekja e shkallëve të ankimit e bën ankesën të pavlefshme**".*

III.1.13. Sa më sipër KPP gjykon se, operatori ekonomik ankimues, në respektim të shkallëve të ankimimit, duhet të kishte ngritur pretendimet lidhur me skualifikimin e ofertës së tij së pari pranë autoritetit kontraktor, ashtu sikurse është përcaktuar specifikisht në ligjin e prokurimit publik e më pas edhe në Komisionin e Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se, nuk mund të shprehet mbi pretendime të cilat nuk janë bërë paraprakisht objekt ankese pranë autoritetit kontraktor. Rezultoi e provuar se, nga ana e ankimuesit është paraqitur vetëm një formular ankese drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik më datë 02.09.2021 dhe autoritetit kontraktor më datë 03.09.2021. Konkretisht, referuar informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, operatit ekonomik “Sark” SHPK dhe Posta Shqiptare SHA., rezulton se, ky operator ekonomik ankimues nuk ka zbatuar hierarkinë për ankimimin e procedurës, referuar nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pasi në Komisionin e Prokurimit Publik, është depozituar më datë 02.09.2021 formular ankese nga ky ankimues, gjatë afatit të shqyrtimit administrativ të ankesave për vlerësimin e procedurës, përpara se të ankimonte skualifikimin e tij pranë autoritetit kontraktor Bashkia Kavajë, duke mos respektuar afatet e ankimimit sipas kuadrit ligjor të prokurimeve në fuqi në kohën e zhvillimit të procedurës objekt-ankimi.

III.1.14. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimimit, duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga “elementet e domosdoshëm të ankesës”, referuar nenit 26, pikës 3, shkronja “a”, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, për shkak të mosrespektimit të afateve të ankimimit. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve (ndër to dhe ai i ankimimit), është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

III.1.15. Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin në fjalë, ankimi administrativ i paraqitur nga operatori ankimues pranë Komisionit të Prokurimit Publik nuk mund të konsiderohet si ezaurim i afateve ligjore që duhet të ndjekë një ankim administrativ pasi, për faj të vetë ankimuesit, ankimimi nuk është realizuar sipas kriterëve të domosdoshme të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Në këto kushte sa më sipër analizuar, pretendimet e mësipërme të ngritura nga operatori ekonomik ankimues nuk do të merren në shqyrtim për shkak të mosndjekjes së shkallëve të ankimimit në lidhje me arsyet e skualifikimit të ofertës së tij në respekt të legjislacionit për prokurimin publik.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.

596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Sark” SHPK për procedurën e prokurimit, “Kërkesë për Propozime”, Nr. REF-85860-02-03-2021 me objekt “Blerje çakëlli”, me fond limit 5,832,684 (pesë milion e tetëqind e tridhjetë e dy mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 15.02.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kavajë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1646 Protokoli, Datë 02.09.2021.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	Anëtar	Anëtar
Fiorent Zguro	Kreshnik Ternova	Anila Malaj

Kryetar

Jonaid Myzyri